

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizimin dhe punën në organet e administratës shtetërore („Gazeta Zyrtare e Republikë së Maqedonisë“ nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11), si dhe në bazë të nenit 22 dhe 25 të Ligjit për arsim të mesém („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82/1999, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 30/2016, 67/2017 dhe 64/2018, Ministri i Arsimit dhe Shkencës solli programin e shkurtuar mësimor për lëndën mësimore **Gjeografi** për **vitin I** të gjimnazit për vitin shkollor 2020/2021.

## 1. Hyrje

Programi i shkurtuar mësimor nga lënda mësimore Gjeografi për vitin I në gjimnaz bazohet në qëllimet/rezultatet e pritura të parapara me programin mësimor që realizohet rregullisht sipas planit mësimor të përcaktuar.

Me këtë program të shkurtuar mësimor përcaktohen tema dhe njësi mësimore të caktuara, që duhet të realizohen në 159 ditë mësimdhënje, duke respektuar fondin e planifikuar favor të orëve mësimore të përcaktuara në programin e rregullt, domethënë, për një lëndë me 2 orë në javë, në programin e shkurtuar janë parashikuar 64 orë mësimore në vit.

Mësimdhënësi gjatë planifikimit dhe realizimit të përmbajtjeve mësimore nga programi i shkurtuar mësimor udhëhiqet nga qëllimet, rezultatet e pritura, konceptet, veprimtaritë dhe metodat e përcaktuara në programin e rregullt mësimor.

## 2. Pasqyrë e temave dhe përmbajtjeve mësimore

Në programin e shkurtuar mësimor janë paraparë 37 orë për realizimin e përmbajtjeve të reja mësimore dhe 27 orë për përsëritje, përforcim dhe sistematizim të të arriturave.

### Tema/ Fusha programore

**Tema I: Hyrje - Galaktika dhe trupat qiellor – (4+3 orë) (4 orë realizim të njësive të reja, 3 orë përsëritje dhe përforcim)**  
Përmbajtjet mësimore:

- Hyrje për gjeografinë fizike;
- Yjet;
- Dielli dhe Sistemi diellor;
- Planetët, satelitët, Hëna dhe menytë e Hënës;

**Tema II: Toka si trup qiellor dhe lëvizjet e tokës – (3+2 orë)**

Përmbajtjet mësimore:

- Forma dhe madhësia (dimenzionet) e Tokës;
- Rotacioni i Tokës;
- Revolucioni i Tokës.

### **Tema III: Paraqitja e sipërfaqes së Tokës në hartë – (4+3 orë)**

Përmbajtjet mësimore:

- Globi, paralelet dhe meridianet;
- Gjërësia dhe gjatësia gjeografike;
- Nga globin në hartë dhe shkalla e përpjestimit;
- Ndarja e hartave sipas përfshirjes teritoriale, shkallës së përpjestimit, përfshirjes dhe përmbajtjes.

### **Tema IV: Karakteristikat fizike – gjeografike të Tokës dhe litosfera - (6+4 orë)**

Përmbajtjet mësimore:

- Evulucioni gjeologjik dhe ndërtimi i Tokës;
- Përbërja gjeologjike e Tokës ( llojet e shkëmbinjve);
- Format e reliefit nën ndikimin e fuqive të brendshme;
- Format e reliefit nën ndikimin e fuqive të jashtme;
- Tipat gjenetik të reliefit;
- Radhitja e kontinenteve në Tokë.

### **Tema V: Hidrosfera (4+3 orë)**

Përmbajtjet mësimore:

- Qarkullimi i ujit dhe shpërndarja e ujrave në Tokë;
- Deti Botëror;
- Ujrat nëntokësor;
- Ujrat tokësor.

### **Tema VI: Atmosfera (5+4 orë)**

Përmbajtjet mësimore:

- Struktura e atmosferës;
- Faktorët klimatikë dhe elementet klimatike;
- Koha dhe klima;
- Brezat klimatik;
- Tipet klimatike.

## Tema VII: Biosfera (3+2 orë)

Përmbajtjet mësimore:

- Faktorët abiotic dhe biotic;
- Shpërndarja gjeografike e botës bimore;
- Shpërndarja gjeografike e botës shtazore.

## Tema VIII: Popullsia dhe vendbanimet (3+2 orë)

- Gjendja numerike, shtimi natyrore dhe migrimet;
- Shpërndarja dhe dendësia e popullsisë;
- Tipet e vendbaneve.

## Tema IX: Veçoritë ekonomike – gjeografike të Tokës (5+4 orë)

- Bujqësia;
- Pasuri mineralogjike dhe burimet energjetike;
- Industria;
- Komunikacioni dhe tregtia;
- Turizmi.

### 3. Rekomandimet didaktike

Planifikimi i orës mësimore nga lënda Gjeografi për vitin I të gjimnazit, që është paraparë me këtë program të shkurtuar mësimor, përfshin përbajtjet programore nga 9 temat e caktuara në programin mësimor të rregullt. Ndërsa temat: Veçoritë kulturore-gjeografike dhe Veçoritë politike-gjeografike, nuk janë përfshirë. Për secilën temë është paraparë numër i caktuar i orëve mësimore, me qëllim që të përvetësohen temat më kryesore nga programi mësimor i lëndës së gjeografisë për vitin I të gjimnazit dhe të njejtat të realizohen për 64 orë në kohëzgjatje prej 159 ditë.

Mësimdhënësi gjatë planifikimit dhe realizimit të përbajtjeve mësimore nga programi i shkurtuar mësimor udhëhiqet nga qëllimet, rezultatet e pritura, konceptet, veprimtaritë dhe metodat e përcaktuara në programin e rregullt mësimor, por për të njejtat parashtron pyetje dhe detyra nga nivele të ndryshme vështirësie, udhëhequr gjithmonë nga propozim-aktivitetet duke i plotësuar ato sipas nevojave të nxënësve.

Në këtë program të shkurtuar mësimor është dhënë propozim për planifikimin e orëve mësimorë për të realizuar temat dhe qëllimet mësimore. Sidoqoftë, mësimdhënësi duhet të planifikojë në mënyrë të pavarur fondin e orëve për realizim të plotë dhe të suksesshëm të qëllimeve të vendosura në programin mësimor. Duke pasur parasyshë që përbërja e nxënësve në klasa është heterogjene, mësimdhënësit duhet të praktikojnë qasje të diferencuar dhe të individualizuar brenda realizimit të mësimdhënies. Qasje e tillë është në funksion të nevojave specifike individuale të secilit nxënës si dhe zhvillimit të potencialeve dhe arritjeve individuale.

Në programin e shkurtuar për lëndën **Gjeografi** për vitin I të gjimnazit, disa përbajtje mësimore mungojnë, disa janë kapërcyes, disa janë shkurtuar e disa të tjera janë ndërlidhur. Zakonisht, janë ato përbajtje mësimore që nxënësit i kanë hasur në vitet paraprake ose që do t'i hasin në vitet në vijim. Kjo është bërë me qëllim të realizimit papengesa të këtij program të shkurtuar mësimor.

#### **Rekomandohet përdorimi i mjeteve mësimore vijuese:**

- libër shkollor i zgjedhur në nivelin e shkollës për lëndën përkatëse i miratuar nga ministria;
- burime të tjera të të mësuarit të gjendura në afërsi - objekte dhe fenomene natyrore;
- enciklopedi të ndryshme, atlase, etj;
- Internet, softuere të ndryshme arsimore;
- revista;
- mjete audio-vizuale.

Teknologja moderne didaktike e të mësuarit të gjeografisë përveç përdorimit të hartave të ndryshme, jep mundësi të jashtëzakonshme për përdorim të kompjuterin, gjegjësisht, zbatim të gjerë të gjeoinformatikës në mësimdhënien e kësaj lënde. Gjithashtu, në mësimdhënie mund të përdoren edhe hartat memece dhe harta tjera të ndryshme, literaturë gjeografike, doracak për mësimdhënie, etj. Konceptet e reja të mësuara do të paraqesin azhurnim dhe zgjerim të koncepteve tashmë të mësuara. Gjatë interpretimit dhe përshkrimit që bëjnë nxënësit, është i nevojshëm inkurajimi nga mësimdhënësi në mënyrën që i përshtatet karakteristikave individuale të nxënësit. Të shprehurit mund të jetë edhe përmes: të folurit, esesë, metodave ilustruese, përpunimit të skemave, grafikëve, etj. Përdorimi i emrave dhe të dhënavë shifrore duhet të thjeshtëzohen në një nivel të arsyeshëm. Gjatë mësimdhënies, vazhdimisht përcjellen dhe vlerësohen arritjet e nxënëve, mblidhen treguesit për aktivitetet e tyre, motivimi për të mësuar, bashkëpunimi me të tjerët, etj. (vlerësimi formativ). Rekomandohet të përdoren mënyrat vijuese

për përcjelljen, kontrollimin dhe vlerësimin e të arriturave të nxënësve në kuadër të temave mësimore: gojarisht, me shkrim, në praktikë (përpjekje, ushtrime dhe ngjashëm), puna në grupe, pjesëmarrje në hulumtim dhe prezantim.

#### **4. Normativi për kuadrin mësimor**

Programin e shkurtuar mësimor e realizon mësimdhënësi në përputhje me normativin për kuadrin mësimor nga programi i rregullt mësimor.

Programin e shkurtuar mësimor nga lënda **Gjeografi për vitin I** të gjimnazit e miratoi

Ministër  
Mila Carovska

---